



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**ENTI RREGULATOR I ENERGJISË**  
**BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 128, Datë 25.06.2024**

**MBI**

**KËRKESËN E SHOQËRISË “TIRANA ENERGJI” SH.P.K. PËR  
DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË  
KONTROLLON INTERESAT E SAJ**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 5, 7, 9, pika dhe 5, dhe nenit 10 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.06.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 213/7 prot., datë 24.06.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “TIRANA ENERGJI” sh.p.k. për dhënie autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “TIRANA ENERGJI” sh.p.k., e licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin e bordit të ERE-s nr. 174, datë 04.11.2020, me shkresën nr. 12 prot., datë 13.02.2024, protokolluar në ERE me nr. 213/2 prot., datë 13.02.2024, ka paraqitur kërkesë dhe dokumentacion për marrjen e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e kësaj shoqërie.
- Pas shqyrtimit paraprak të kërkesës dhe dokumentacionit bashkëlidhur, ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 213/3 prot., datë 23.02.2024, duke i evidentuar informacionin/dokumentacionin e munguar të aplikimit të saj.
- Në vijim, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 213/4 prot., datë 29.04.2024, shoqëria ka kërkuar mirëkuptimin e ERE-s për mos përgjigjen në kohë, për shkak të vonësës së marrjes së shkresës nga stafi administrativ dhe ka depozituar informacion dhe dokumentacion plotësues të aplikimit, nga shqyrtimi i të cilit u konstatua nevoja për plotësim të mëtejshëm të tij, ndaj ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 213/5 prot., datë 27.05.2024.

- Në vijim, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 213/4 prot., datë 29.04.2024, shoqëria ka kërkuar mirëkuptimin e ERE-s për mospërgjigjen në kohë, për shkak të vonesës së marrjes së shkresës nga ana e stafit administrativ dhe ka depozituar informacion dhe dokumentacion plotësues të aplikimit, nga shqyrtimi i të cilit u konstatua nevoja për plotësim të mëtejshëm të tij, ndaj ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 213/5 prot., datë 27.05.2024.
- Në përgjigje, me shkresën nr. 213/6 prot., datë 31.05.2024, shoqëria ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar.
- Duke qenë se akti i kalimit të kuotave është nënshkruar përpara se të merrej autorizimi përkatës i ERE-s për këtë transferim, në ERE është depozituar deklarata e përbashkët e shitësit (ortakut të mëparshëm) dhe blerësit dhe administratorit të shoqërisë (ortakut aktual), ku përcaktohet se kuotat do të kalojnë në gjendjen e mëparshme në rast të mosmarrjes së autorizimit nga ERE.
- Pas analizimit të kërkesës dhe dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria me korrespondencën vijuese të realizuar me ERE-n, rezulton se ajo ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar në nenin 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021.
- Shoqëria “TIRANA ENERGJI” sh.p.k. nuk ka detyrime të pashlyera ndaj ERE-s për sa i përket pagesave të rregullimit.
- Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “TIRANA ENERGJI” sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “TIRANA ENERGJI” sh.p.k.
2. Ortaku i vetëm i shoqërisë “TIRANA ENERGJI” sh.p.k. bëhet Z. Bledar Hasalamaj.
3. Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “TIRANA ENERGJI” sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “TIRANA ENERGJI” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**